



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2524/₁₉ Prot.

Tiranë, më 20.10. 2025

V E N D I M

Nr. 128 dt. 20.10 2025

“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË MARRDHËNIEVE ME STUDENTËT”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 4, pika a, neni 33 paragrafi 3, neni 37, neni 38 të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi nr.57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 7 paragrafi 4 pika b, neni 20, neni 26 të Statutit të UST-së, në nenin 7, nenin 10 të Rregullores së UST-së, Vendimin e Rektoratit Nr.119, datë 14.10.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.10.2025

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët (bashkëlidhur vendimit);
2. Neni 4 pika 1 dhe 2 ishte:

Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga të cilët:

-3 (tre) anëtarë janë staf akademik nga një përfaqësues për fakultet;

-1 (një) anëtar i propozuar nga Rektorati i UST;

1 (një) anëtar nga studentët.

Të gjithë anëtarët vetëkandidohen dhe më pas përzgjidhen nga Senati Akademik me një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bëhet:

Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga të cilët:

-3 (tre) anëtarë janë staf akademik nga një përfaqësues për fakultet;

-1 (një) anëtar është personel ndihmës akademik me karakter administrativ nga drejtoria që mbulon marrëdhëniet me studentët, alumni, koordinimin dhe komunikimin;

1 (një) anëtar nga studentët.

Të gjithë anëtarët vetëkandidohen dhe më pas për zgjidhen nga Senati Akademik me një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Ky Vendim i përcillet për njohje të gjitha njësive përbërëse të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

